



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në Prishtinë me datën 21.04.2022 nga

I.

Sindikata e Policisë së Republikës së Kosovës, të cilën e përfaqëson z.Imer Zeqiri, në tekstin vijues, SINDIKATA-PK

II.

Ordinanca mjekësore AGAJ-MEDICAL SH.P.K, Lagjja e spitalit, Rr.Malush Kosova, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Dr. Atdhe Agaj, Drejtor

Neni
Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim që t'u mundësojë të gjithë Pjesëtarëve të Policisë të Republikës së Kosovës të marrin shërbimet në institucionin shëndetësor AGAJ-MEDICAL sipas kriterëve të parapara në këtë marrëveshje.

Neni 2

Obligimet e Institucionit Shëndetësor

Obligimet e Institucionit Shëndetësor:

2.1. **Institucioni Shëndetësor** do t'i mundësojë të gjithë Pjesëtarëve të Policisë së Kosovës shërbime cilësore dhe përkujdesje maksimale në shërbimet që ofron Institucioni.

2.2. Institucioni Shëndetësor do të ofrojë 30 % zbritje për të gjitha shërbimet e Institucionit,

2.3. Përfituesit e shërbimeve me zbritje sipas parag. 2.2 do të jenë të gjithë Pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe familja e ngushtë e tyre si: bashkëshortja, fëmijët, nëna dhe babai i Pjesëtarit të Policisë.

- **Shërbimet që ofron kjo Ordinanca janë: Vizita mjekësore, Vizita mjekësore shtëpiake,**
- **Vizitë mjekësore specialitike Kardiologjike, Internistike, Onkologjike, dhe nga specialisti i mjekësisë familjare.**
- **Kujdesi dhe përpunimi i plagëve, dhënia e injeksioneve, dhënia e infuzioneve, inhalime, vendosja dhe ndërrimi i kateterit urinar, marrja e gjakut dhe urinës për analiza, EKG me interpretim, klizma pastruese, vendosja e sondës nasogastrike, trajnimi i dekubitit, punkcioni abdominal (largimi i langut nga barku), qepja e plageve, largimi i**

- penjeve, aspirimi i sekreteve nga goja dhe faringu, lavazha gastrike, matja e oksigjenit ne gjak, ndërrimin e gipsit*
- *Vrejje - transporti mjekësor për të sëmurit brenda dhe jashtë Kosovës, Asistenca në shtëpi dhe spitale 4/8/12/24 orë varet varsisht nga largesia perkatesisht nga kerkesat nga ana e familjareve te pacientit edhe ketu do te kete zbritje prej 30 %.*
 - *Sherbimi shtepiake varsisht prej largesise edhe ketu do te perfshihet zbritje prej 30 %*

Neni 3 Obligimet e SPK-së

- 3.1. **Sindikata e Policisë së Republikës së Kosovës** do të sigurohet që t'i njoftojë të gjithë Pjesëtarët e Policisë në Republikën e Kosovës rreth bashkëpunimit dhe përfitimit të shërbimeve në Institucionin Shëndetësor.
- 3.2. Pjesëtarët e Policisë bëjnë pagesën e mbetur pas zbritjes 30% duke respektuar proceduarat që ka "AGAJ-MEDICAL".

Neni 4 Ndryshimi i Marrëveshjes

4.1 Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme deri në momentin kur të dyja palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për ndërprerjen e bashkëpunimit në mes tyre, në afat prej 7 ditësh.

4.2 Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe të ndryshohet në çdo kohë kur palët në bashkëpunim shprehin vullnetin e tyre për t'a ndryshuar.

Neni 5

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përpiluar në 2 kopje identike, prej të cilave nga një kopje iu dorëzohen palëve dhe e njëjta hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Palët nënshkruese

Sindikata e Policisë së Republikës së Kosovës


Z. Imer Zeqiri



**Ordinanca mjekësore
"AGAJ-MEDICAL"**


Dr. Atthe Agaj, Drejtor



AGA J-MEDICAL SH.P.K

ÇMIMORE

Arka:	Ordinance:	Teren:
1. VIZ. MJEKËSORE	15.00	20.00
2. INFUZIONE	7.00	10.00
3. INJEKSION	5.00	7.00
4. SH. SHTËPIAK		10.00
5. INHALIMI	5.00	7.00
6. EKG	5.00	10.00
7. VENDOSJA E SNG	40.00	50.00
8. KLIZMA	40.00	50.00
9. PASTRIMI I PLAGËVE	10.00	20.00
10. ASISTENCË E PERGJ.	60.00	60.00
11. KAT. URINAR	15.00	20.00
12. MARRJA E GJAKUT	5.00	10.00
13. MATJA E GLIKEMIS	3.00	3.00
14. PARA. VITAL	3.00	5.00
15. TRAJ. I DEKUBITIT	20.00	30.00
16. KOLLOSTOMA	10.00	20.00
17. TRANSPORT MJEKËSOR	20.00	50.00
18. TË TJERA.	10.00	20.00

